REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1723 Prot Tiranë, më 30/10/2019

**REKOMANDIM**

**Nr. 56, datë 30/10/2019**

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS SË AUTORITETIT PUBLIK "INSTITUCIONI I KOMISIONERËVE PUBLIK"**

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: http://ikp.al/programi-i-transparences/, të Autoritetit Publik "Institucioni i Komisionerëve Publik" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

*a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
*b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*
*c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet

Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tirane". Telefon:00355 42237200 www.idp.al info@idp.al

përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në "Programi i Transparencës" në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pjesërisht të ndërlidhura me programin e transparencës (të linkuara).

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

*dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;*

*e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;*

*ë) informacion për procedurat, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;*

*gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
*k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.*

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

*f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;*
*l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.*

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Përsa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 *"Për të Drejtën e Informimit"*, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar,

**REKOMANDOJ :**

1. Autoriteti Publik/Institucioni i Komisionerëve Publik, në zbatim të gërmave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 30.10.2019.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TIRANË

**Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Institucioni i Komisionerëve Publik – datë 29.10.2019**

**Institucioni i Komisionerëve Publik** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: http://ikp.al/programi-i-transparences/.
Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në "Transparenca", dhe Programi i transparencës është ndërlidhur në këtë menu.

Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015. Nga monitorimi rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, janë pjesërisht të publikuara dhe të ndërlidhura (të linkueshme) me faqen kryesore në të cilën ndodhet informacioni.

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



**VENDIM**
**Nr. 102/2018**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 94/2017, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË"**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionerëve Publikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, "Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerëve Publikë", e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, zëvendësohet sipas lidhjes nr. 1, "Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionerëve Publikë", që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
II. Lidhja nr. 2, "Struktura organizative e Komisionerëve Publikë", e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, zëvendësohet sipas lidhjes nr. 2, "Struktura organizative e Komisionerëve Publikë", që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.
III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 4.10.2018

Aneks-2-pershkrimet-e-punes.pdf

1 / 20

**PËRSHKRIMET E PUNËS PËR PUNONJËSIT E INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË**

**DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

E shprehur në organigramë, Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse ka një varësi hierarkike si më poshtë:

**Kancelari**
↓
**Drejtor drejtorie**
↓
**Specialistë**

**Emërtimi: DREJTOR NË DREJTORINË EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**Varësia:** Për kryerjen e detyrave të tij funksionale, punonjësi ka varësi të drejtpërdrejtë nga Kancelari i institucionit.

**Qëllimi:** Organizimi i punës, administrimi dhe mbajtja me efektivitet i fondeve buxhetore, protokollit, shërbimeve të IT-së, menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe shërbimeve mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi.




7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

KREU | RRETH NESH | LEGJISLACIONI | ANKIME | MOSANKIME | REKOMANDIME | TRANSPARENCA | NJOFTIME | KONTAKT

LEGJISLACIONI

**INFORMOHU MBI LEGJISLACIONIN**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Aneksi i Kushtetutës

Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Ligji nr.49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Rregullorja "Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë".

Rregullore e brendshme administrative e Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Institucionin e Komisionerëve Publikë".

Rregullore për median.

Rregullore-e-brendshme-administrative-e-Institucionit-të-Komisionerëve-Publikë.pdf 1 / 56

RREGULLORE E BRENDSHME ADMINISTRATIVE E INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar në faqe dhe i ndërlidhur në programin e transparencës;**



KËRKESË PËR INFORMACION

| | | |
|---|---|---|
| Emër Mbiemër: Z./Znj. ______ | Adresa postare: ______ Adresa elektronike: ______ Nr. Tel. | Data: __/__/201_ Nënshkrimi: |

[illegible]

| Përshkrimi i detajuar i informacionit të kërkuar |
|---|
| |

| Të tjera të dhëna |
|---|
| |

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: ______

| Vetëm për përdorim zyrtar | | |
|---|---|---|
| Data e marrjes: __/__/201_ | Numri rendor i kërkesës: | Komente: ______ |

[illegible] 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"

- [illegible]
- [illegible]
- [illegible] Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.




7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në faqe, si dhe në programin e transparencës;**



ikp.al/programi-i-transparences/

KREU | RRETH NESH | LEGJISLACIONI | ANKIME | MOSANKIME | REKOMANDIME | TRANSPARENCA | NJOFTIME | KONTAKT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Akte ndërkombëtare ... dokument politikash, dokument bazë | Neni 7/1/b i ligjit nr. 119/2014 | Ligje, akte nënligjore, vendime të titullarit të institucionit, rregullore të brendshme | Menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Menjëherë pas urdhrit të miratimit nga Komisionerët Publikë | Në faqen zyrtare në menunë "Legjislacioni" | Koordinatori për të drejtën e informimit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun |
| Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit | Neni 7/1/c/g i ligjit nr. 119/2014 | Format kërkese "KËRKESË PËR INFORMACION" Format ankese "FORMULARI I ANKESËS" Adresa: **Institucioni i Komisionerëve Publikë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Njësia Administrative nr. 5, Kodi postar 1019, nr. 8, Tiranë, Shqipëri** Orari i punës: E hënë – E enjte 08.00 – 16.30 E premte 08.00 – 14.00 E-mail: info@ikp.al | Menjëherë në rast ndryshimesh | Në faqen zyrtare të IKP-së www.ikp.al në menunë "Transparenca" | Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Publikun/ Koordinatori për median dhe marrëdhëniet me jashtë |

Drejtoria e Menaxhimit të



ikp.al/koordinatori-per-te-drejten-e-informimit/

AL EN DENONCO

IKP Institucioni i Komisionerëve Publikë

KREU | RRETH NESH | LEGJISLACIONI | ANKIME | MOSANKIME | REKOMANDIME | TRANSPARENCA | NJOFTIME | KONTAKT

Koordinatori për të drejtën e informimit

**Emër/Mbiemër:** Alida Tota

**E-mail:** alidatota@ikp.al

**Adresa e institucionit:** Institucioni i Komisionerëve Publikë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Njësia Administrative nr. 5, Kodi postar 1019, nr. 8, Tiranë, Shqipëri

**Orari i punës:**

E hënë – E enjte 08.00 – 16.30

E premte 08.00 – 14.00

**ANKIME**

Ankim kundër vendimit nr. 187, datë 24.7.2019, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj

**MOSANKIME**

Njoftim për mosankimin e vendimit nr. 196, datë 8.10.2019, të KPK-së, për subjektin e rivlerësimit znj. Ema Gashi

7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**






7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni nuk është i publikuar në faqen e autoritetit;**

7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqe dhe është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës.**


Buxheti vjetor i miratuar për vitin 2019


KOMISIONERËT PUBLIKË
RELACION
TOTALI



7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; **Informacioni është pjesërisht i publikuar në faqe.**



**Regjistri i realizimeve të prokurimit publik**

Për vitin: 4 mujori i dytë i vitit 2019 maj - gusht 2019

Autoriteti Kontraktor: Institucioni i Komisionerit Publik

| Nr | Objekti i Prokurimit | Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim) i Marrëveshje Kuadër | Lloji i Procedurës së Prokurimit | Fondi limit me të cilin është shpallur procedura | Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit | Emri i operatorit ekonomik i shpallur fitues | NUIS | Vlera e kontratës | Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqendruara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerje libra dhe botime | Mallra | Blerje nën vlerën 100,000 lekë | 100000 | 18/7/2019 | Qendra e Botimeve Zyrtare | K02224003O | 93652.00 | |
| 2 | Blerje materialesh të tjera dhe shërbimesh speciale | Mallra | Blerje nën vlerën 100,000 lekë | 100000 | 14/5/2019 | MEGATEK | K81507050O | 8033.00 | |
| 3 | Blerje pajisje dhe mobilje zyre | Mallra | Small Value | 441667 | 16/05/2019 11:00 AM | EURO OFFICE | K31803032W | 123700.00 | |
| | | | | | 03/06/2019 11:30 AM | TRINITY TRADE COMPANY | K81530029U | 162000.00 | |
| 4 | Blerje pajisjesh kompjuterike dhe elektronike | Mallra | Small Value | 608333 | 28/06/2019 02:00 PM | PC STORE | L01606034A | 548400.00 | |
| 5 | Blerje ujë i pijshëm për nevojat e institucionit | Mallra | Blerje nën vlerën 100,000 lekë | 100000 | 28/6/2019 | LAJTHIZA INVEST | J98009202P | 8333.00 | |
| | | | | | 7/6/2019 | LAJTHIZA INVEST | J98009202P | 8333.00 | |
| | | | | | 14/5/2019 | LAJTHIZA INVEST | J98009202P | 8333.00 | |
| | | | | | 19/7/2019 | LAJTHIZA INVEST | J98009202P | 8333.00 | |
| | | | | | 27/8/2019 | LAJTHIZA INVEST | J98009202P | 8833.00 | |
| 6 | Shërbime të tjera transporti (larje makine, etj) | Shërbime | Blerje nën vlerën 100,000 lekë | 83333 | 27/6/2019 | PERPARIM HAKA | L52109098L | 4000.00 | |
| | | | | | 2/8/2019 | PERPARIM HAKA | L52109098L | 4000.00 | |
| | | | | | 31/5/2019 | PERPARIM HAKA | L52109098L | 4000.00 | |
| 7 | Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve (elektrike teknike kondicioner etj) | Shërbime | Blerje nën vlerën 100,000 lekë | 100000 | 28/6/2019 | MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI | L62102007V | 7200.00 | |
| | | | | | 8/8/2019 | JANI KONTI | L21708031N | 9800.00 | |

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe. Në tabelën e programit model të transparencës për këtë kërkesë të ligjit rezulton bashkëlidhur regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve dhe formulari i denoncimit.**

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni është i publikuar në faqe dhe është ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**



KREU | RRETH NESH | LEGJISLACIONI | ANKIME | MOSANKIME | REKOMANDIME

TRANSPARENCA | NJOFTIME | KONTAKT

DENONCO

## FORMULAR I DENONCIMIT NGA PUBLIKU

TE DHENAT E DENONCUESIT

Emer *

Atesi *

Mbiemer *

Email-i (Ju lutem vendosni adresën e saktë të email-it)

Numri personal i identifikimit



Model-Format-Ankese.pdf

**FORMULAR ANKESE**

**Drejtuar**
**Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"**

| |
|---|
| **Emri / Mbiemri**[1] : |
| **Adresa:** |
| **Qyteti :** |
| **Telefon:** |
| **E-mail:** |

| |
|---|
| **Autoriteti Publik :** |
| **Adresa:** |
| **Qyteti:** |

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhini ato.

Përshkruani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 119/2014.

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit model të transparencës.**

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; - **Informacioni është i publikuar në faqe si dhe është ndërlidhur në programin e transparencës;**




Lista tip e dokumenteve dhe afatet përkatëse të ruajtjes

| Nr. | Emërtimi | Afati i ruajtjes |
|---|---|---|
| 1 | Dokumente për krijimin, organizimin dhe funksionimin e IKP-së<br>- Vendime<br>- Skema organizative<br>- Rregullore | Ruhen përgjithmonë |
| 2 | Dokumenta të Mbledhjes se Komisionerëve<br>- Urdhëra, Vendimet, Relacione | Ruhen përgjithmonë |
| 3 | Korrespondenca me institucione | Ruhen përgjithmonë |
| 4 | Korrespondencë e thjeshtë për marrëdhëniet me publikun<br>- Kërkesa<br>- Ankesa | Ruhen 5-10 vjet |
| 5 | Dokumenta për strukturën organizative, kategorizimin dhe fondin e pagave<br>Vendime, udhëzime, organika, pasqyra, borderotë e pagave, libri i pagave | Ruhen përgjithmonë |
| 6 | Dokumenta për hartimin dhe zbatimin e buxhetit<br>- Evidenca përmbledhëse, ligje, vendime, projektbuxheti, detajimi i buxhetit, situacione dhe evidenca periodike | Ruhen përgjithmonë |
| 7 | Dokumenta të thesarit | Ruhen përgjithmonë |
| 8 | Dokumenta për problemet të kontabilitetit<br>- Vendime<br>- Udhëzime<br>- Bilance vjetore | Ruhen përgjithmonë |
| 9 | Dokumenta mbi sigurimet shoqërore<br>Ligje, vendime, udhëzime, raporte, evidenca, relacione përmbledhëse | Ruhen përgjithmonë |
| 10 | Dokumenta për treguesit e pagave, rritja reale e pagës mesatare mujore, pagat sipas grupprofesioneve, ligje, vendime | Ruhen përgjithmonë |
| 11 | Dokumenta [illegible], masa disiplinore, etj.<br>Ruhen përgjithmonë | Ruhen përgjithmonë |
| 12 | Dokumente për inventarin fizik të mjeteve kryesore dhe materialeve [illegible] | Ruhen përgjithmonë |
| 13 | Dokumenta për kontrollin financiar<br>Autokontrolle për problemet të rëndësishme ose për problema të zakonshme | Ruhen përgjithmonë |
| 14 | Dosja personale të personelit | Ruhen përgjithmonë |
| 15 | Dokumenta ligjore, procesverbale, vendime për ankime/ rekomandime, relacione, fashikuj etj. | Ruhen përgjithmonë |

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni është i publikuar, i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës, si dhe është i përditësuar.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2019

| NR/ RENDOR | DATA E REGJISTRIMIT TË KËRKESËS | OBJEKTI | DATA E KTHIMIT PËRGJIGJES | STATUSI I KËRKESËS | TARIFA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 4.2.2019 | Informacion lidhur me veprimtarinë e IKP-së | 15.2.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 2. | 5.2.2019 | Informacion mbi "Rregulloren për median" | 5.2.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 3. | 14.3.2019 | Kërkesë për informacion lidhur me kualifikimet e stafit të IKP-së | 28.3.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 4. | 8.5.2019 | Kërkesë për informacion statistikor lidhur me numrin e ankimeve të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë | 8.5.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 5. | 20.5.2019 | Kërkesë informacioni lidhur me statusin e ankimimeve dhe publikimet në faqen zyrtare të IKP-së | 21.5.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 6. | 19.6.2019 | Dokument kopje e praktikës së protokollimit të ankimit të vendimit nr. 32, dt. 5.7.2018 të KPK-së | 21.6.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 7. | 21.6.2019 | Dokument kopje e protokollimit të vendimit nr. 32, dt 5.7.2018, të njoftuar nga KPK | 24.6.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 8. | 12.7.2019 | Kërkesë informacioni mbi denoncimet nga publiku | 16.7.2019 | Përfunduar | S'ka |
| 9. | 23.7.2019 | Kërkesë koment për procedurat administrative në procesin e rivlerësimit | 29.7.2019 | Përfunduar | S'ka |

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit të transparencës;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

RAPORT STATISTIKOR

Periudha: janar – shtator 2019

| VENDIME TË NJOFTUARA NGA KPK (Fundi i dhjetorit 2018) | VENDIME TË NJOFTUARA NGA KPK (Janar - shtator 2019) | VENDIME TË SHQYRTUARA NGA IKP | ANKIME | MOSANKIME | NË PROCES | DENONCIME NGA PUBLIKU |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 183 | 181 | 8 | 92 | 6 | 277 |

Institucioni i Komisionerëve Publikë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 8, Tiranë, info@ikp.al, www.ikp.al

7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik . **Informacioni është i publikuar faqe dhe i ndërlidhur në tabelën e programit model të transparencës.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

RREGULLORE
PËR
MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË
E TË DHËNAVE PERSONALE NË
INSTITUCIONIN E KOMISIONERËVE PUBLIKË (IKP)

Miratuar me vendimin nr. 14, datë 10.10.2018, Tiranë

1

| **Autoriteti Publik** | Institucioni i Komisionerëve Publik |
|---|---|
| Programi i transparencës | Po |
| Koordinatori | Po |
| 7.1.aPërshkrim/struktura, funksionet dhe detyrate A.P | Po |
| 7.1.b Tekst. e plota të konventa, ligje, akteve | Po |
| 7.1.c Procedura për kërkesë për informacion | Po |
| 7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP | Po |
| 7.dTë dhënat për arsim,pagat | Po |
| 7.1.dh Auditi | Jo |
| 7. 1.e Buxheti | Pjesërisht |
| 7.ë Procedurat e Prokurimit | Pjesërisht |
| 7.1.f Shërbimet e A.P | Jo |
| 7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP | Po |
| 7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve | Jo |
| 7.1.h Mbajtja e dok(Arkiva) | Po |
| 7.i Regjistri i kërkesave | Po |
| 7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh | Pjesërisht |
| 7.1.l Çdo Informacion i dobishëm | Pjesërisht |